



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 53, Datë 29.03.2022

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “ADA SOLAR SE” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E  
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1, gërma “e”, nenit 13, të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15, të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i ERE-s , në mbledhjen e tij të datës 29.03.2022, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 406 prot., datë 24.03.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, “*Mbi licencimin e shoqërisë “ADA Solar SE” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike*”,

**Konstatohet se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 37, datë 03.03.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ADA Solar SE” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.
- ERE me shkresën nr. 70/6 prot., datë 04.03.2022, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 18.03.2022), nuk rezultoi të kishte të tilla.
- Në zbatim të përcaktimeve të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*”, e ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE Formatin dhe dokumentacionin për aplikim; Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; Dokumentacionin financiar dhe fiskal dhe Dokumentacionin teknik për aktivitetin e tregtimit të energjise elektrike.  
Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë tërësisht dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim. Neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”. **Plotësuar;**
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor. Neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”. **Plotësuar;**
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal. Neni 9, pika 3, “a”, “b”, “c”, “d”. **Plotësuar;**
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjise elektrike. Neni 9, pika 4.8, gërmat “a”, “b”, “c”. **Plotësuar.** Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike nga ERE në zbatim të Aneksit A, të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjise elektrike”*, e ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të licencojë shoqërinë “ADA Solar SE” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**